

## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “ionaLABOR” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

Z. Rahmi Sabriu, shtetas Shqiptare, i datëlindjes 03/04/1979, lindur në Durrës, banues në Rruga. Ymer Kurti; Nd. 8; H. 3; Ap. 62; Njesia Administrative nr. 5; 1019; Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. leternjoftimi 036102794 dhe nr. personal H904030831.

### *Pjesa e përgjithshme*

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 19/06/2023 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

#### **NENI 1**

##### *Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “ionaLABOR”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### **NENI 2**

##### *Forma*

Shoqëria tregtare “ionaLABOR”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### **NENI 3**

##### *Zyra Qëndrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ionaLABOR”, do të ketë seline e saj qëndrore në: Lagjja nr. 9, Rruga Aleksander Goga, pallat pese katesh, kati i dyte, perballe KMY, zone kadastrale 8513 , dhe me numer pasurie 3/132, Durrës.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### **NENI 4**

##### *Objekti i veprimtarisë*

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Sherbim laborator dentar, sherbime klinike stomatologjike. profilaxi, terapi, ortopedi, kirurgji,

implantologji, ortodonti., kellef, ura proteza te levizshme.

#### **NENI 5**

##### ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë te pakufizuar.

#### **NENI 6**

##### ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “ionaLABOR” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### **NENI 7**

##### ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë “ionaLABOR” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

#### **NENI 8**

##### ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ionaLABOR” SHPK është 100.000 (njqindmije) Leke, e ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Rahmi Sabriu është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

#### **NENI 9**

##### ***Organet e shoqërisë***

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

**NENI 10**

***Administratori***

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. Rahmi Sabriu.

**NENI 11**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

*Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.*

**ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Rahmi Sabriu**

ZAHMI

**DURRES 19/06/2023**

SABRIU

